



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 178, Datë 03.09.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SH.A. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA  
ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKËS) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, gërma “b”, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1774/1 prot., datë 02.09.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekës) të aseteve të paluajtshme të saj”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Ura e Fanit”, “Fangu” dhe “Peshqesh”, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 32, datë 04.03.2015, i ndryshuar, me vendimin e bordit nr. 128, datë 16.08.2017.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1174 prot., datë 19.08.2024, ajo ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit kundrejt marrëveshjes së kredisë sindikale, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., “OTP Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. dhe “Tirana Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Raiffeisen Bank” sh.a.
- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë, në zbatim të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se në këtë aplikim nevojitet të plotësohet dhe sa më poshtë:

**Neni 7 “Përmbajtja e kërkesës për transferim”**

Pika 1: Një përshkrim i të licensuarit që përmban informacion mbi:

- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të bëjë me dije efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve.
- **gërma “d”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores në lidhje me përshkrimin e kandidatit të propozuar për transferimin e aseteve.
- **gërma “e”**: Shoqëria duhet të japë informacion mbi mënyrën se si parashikon të garantojë shlyerjen e rifinancimit dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të licencuar.
- **gërma “f”**: Shoqëria duhet të japë informacion për efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit.
- **gërma “g”**: Shoqëria duhet të japë informacion për efektin në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licencuar.
- **gërma “h”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE listën e aseteve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, me vlerën e secilit aset dhe vlerën totale të tyre, listë e cila duhet të jetë pjesë integrale e marrëveshjes së hipotekës, si dhe të sqarojë pozicionin e bashkë kredimarrësit në marrëveshjen e kredisë. Po ashtu, duhet të depozitojë marrëveshjen e kredisë sindikale dhe atë të hipotekës në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.
- **gërma “i”**: Shoqëria duhet të informojë nëse ka pasur më herët transferime të aseteve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.
- **Pika 3**: Shoqëria duhet të depozitojë korrespondencën e zhvilluar me MIE-n në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.
- **Pika 6**: Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë në ERE që kërkon të mos jetë e hapur për publikun.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj marrëveshjes së kredisë sindikale, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., “OTP Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. dhe “Tirana Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është “Raiffeisen Bank” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “AYEN AS ENERGJI” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**